

Shqipëri-Maqedoni, marrëveshje bashkëpunimi në fushën e akreditimit

Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) dhe Instituti Maqedonas i Akreditimit (IARM) nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi midis tyre. Objekti i marrëveshjes do të jetë bashkëpunimi midis dy organizmave për zhvillimin e një procesi uniform të akreditimit në rajon dhe mbështetja e vazhdueshme për krijimin e aktivitetit të akreditimit midis dy vendeve. Drejtori i Përgjithshëm i DPA, Z. Agim Anxhaku u shpreh se firmosja e marrëveshjes me Maqedoninë zgjeron hartën e bashkëpunimit në nivel rajonal duke e çuar në 5 numrin e vendeve me të cilat ne kemi nënshkruar brenda këtij viti. DPA ka tashmë marrëveshje me organizmin akreditues Grek, Rumun, Malazez dhe atë Kosovar. Këto marrëveshje kanë si objektiv njohjen reciproke të akreditimeve të kryera nga DPA në nivel rajonal, por dhe mbështetja që do të japin këto organizma për arritjen e objektivit që ne i kemi vënë vetes njohjen sa më shpejt të akreditimeve në nivel Europian. Ndërsa Z. Tpe Ristoski, Drejtor i Përgjithshëm i IARM deklaroi se bashkëpunimi midis dy institucioneve ka ekzistuar dhe më parë, por me firmosjen e marrëveshjes



hyn në një fazë të re atë të institucionizimit. Kjo do të sjellë intensifikimin e bashkëpunimit midis organizmit shqiptar dhe atij maqedonas. Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar të dy palët angazhohen të punojnë për reduktimin e barrierave teknike në tregtimin midis Shqipërisë dhe Maqedonisë, nëpërmjet zbatimit të procedurave të njëjta të akreditimit, njohjes reciproke të akreditimit, ç'ka sjell njohjen e raporteve të testimit apo të certifikimeve

të lëshuara nga organizmat të vlerësimit të konformitetit që janë të akredituar nga organizmat akreditues të vendeve respektive. Nga kjo marrëveshje të dy palët kanë të drejtë të organizojnë akreditime dhe vlerësime të përbashkëta, të shkëmbejnë vlerësues dhe krye vlerësues, të marrin pjesë në aktivitete trajnuese dhe vizita studimore të zhvilluara nga organizmat respektive, bashkëpunojnë në organizimin e krahasimeve ndër laboratorike, etj.